



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1124 / Prot.
18

Patos, më 22 / 05 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 20 MAJ 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:30

Dëgjuesë publike me temë: “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, rreth 31 pjesëmarrës (banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj)

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjuesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e
kërkesave buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot për të rishqyrtuar të gjitha kërkesat tuaja që keni paraqitur në dëgjesën e parë mbi kërkesat për hartimin e PBA-së. Nëse keni edhe ndonjë kërkesë shtesë mund ta paraqisni. Ju faleminderit!

Drejtores e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari– përshëndetje të gjithëve! Në këtë fazë buxhetimi ne jemi duke shqyrtuar edhe njëher kërkesat buxhetore përpara së të hartojmë edhe



**Drejtores e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për
vitin 2026”**

Maj 2025

dokumentin e parë për buxhetin. Kërkesat tuaja kanë konsistuar në rionstruksionin e palestrës, infrastruktur rrugore në ujësjellës dhe rrugët e brendshme, shërbim të pastrimit dhe në zonat e munguara, kërkesa lidhur me përmirësimin e ndriçimit rrugor, kënde lojërash për fëmijë, ujë për varrezat dhe kënde lojërash për fëmijë. Këto janë kërkesat e fazës së parë në mënyrë të përmbledhur pak a shumë. Në këtë fazë ne kemi marrë parasyhs kërkesat buxhetore që kanë të bëjnë me infrastrukturën e brendshme sipas kërkesave për tu rikonstruktuar. Po kështu edhe për rrugët bujqësore vazhdon edhe që nga 2025 janë lidhur kontratat dhe vazhdon punë për hapjen e rrugëve bujqësore dhe përmirësimin e infrastrukturës së bujqësisë. Kemi marrë masa dhe kemi lidhur kontratën për ndriçimin rrugor dhe shumë shpejt do të filloj edhe ndriçimi rrugor për linja ekzistuese, por edhe për linjat e reja. Lidhur me ndërtimin e një tualeti publik do ta rishqyrtojmë edhe njëher në kërkesat shtesë që do të bëhen më vonë. Për rikonstruksionin e shkollës “Hekuran Maneku” janë bërë projekte dhe janë aplikuar për konkurim në thirrjet që janë hapur, por deri tani edhe nuk kemi fituar.

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- Faleminderit të gjithëve që keni ardhur! Kjo përmbledhje që bëri drejtoresha e financave për kërkesat e para është edhe hapja e kësaj

dëgjese për të vazhduar edhe më marrjen e kërkesave të tjera shtesë që ju mund të keni mbi hartimin e buxhetit.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Banor i lagjes “1 Maj” Patos, z. Aleksandër Mici – Përshëndetje! Unë jetoj në lagjen “1 Maj” Patos, rruga Unaza dhe kemi patur një problem si pallat prej vitesh. Kemi ardhur edhe në bashki dhe kemi informuar lidhur me gjendjen e këtij pallati. Pallati është i viteve '75, kurse rruga i përket viteve '80 dhe hyrjen ne e kemi nga mbrapa pallatit. Ne nuk dalim dot aty dhe pengohemi nuk kemi rrugë fare. Kemi kërkuar nqë të ndërhyjmë vet privatisht, por nuk na lejuan pasi kalojnë linjat e ujit etj dhe ndërhyrja duhte të bëhet nga bashkia. Tani po thuhet që kjo do rregullohet nga rikonstruksioni i lagjes që do bëhet aty, por unë dua të di çfarë do bëhet sepse nuk lëvizim dot. Është pallat i izoluar ka nevojë për ndërhyrje. Dhe nëse do bëhet rikonstruksion të shikohet pozicioni i lulishteve dhe parkut të lojërave që mos të na shqetësojnë zhurmat pasi ka shumë të moshuar që banojnë aty.



**Banor i lagjes “1 Maj” Patos
z. Aleksandër Mici**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Kryetar i fshatit Rerës, z. Shaban Rucaj- përshëndetje! I dëgjuam të gjitha planifikimet, por për Rerësin nuk kanë filluar dhe nuk janë bërë. Kryesorja janë ujërat e zeza në lagjen

Karemanaj ku nuk është vënë dorë fare. Firma e re ka lënë kanalin sipërfaqësor përjashta. Kemi propozuar për një rrugë që lidh Banaj me Rerësin. Rruga është e gatshme dhe kërkon shpenzime të vogla, shtrim që të lidhet me rrugën e Rerësit deri te kabina të varrezat. Varrezat e Rerësit janë planifikuar dhe nuk kanë vazhduar dhe ujë nuk kanë. Ndriçimi në lagjet Ruçaj, Xhobaj, Karemanj duhet vendosur. Rrugët e brendshme kanë filluar vetëm te Pajajt. Traktori duhet të vij në Rerës për rrugët e parcelave.



**Kryetar i fshatit Rerës
z. Shaban Ruçaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

Banor i lagjes Rerës, z. Bashkim Murataj- Dua të ngre një problem pasi ne jemi gati 20 familje në rrugën lart Buzaj që është rrugë e brendshme e fshatit dhe rruga është në gjendje shumë të keqe pasi aty nuk kalon dot asnjë makinë.



**Banor i lagjes Rerës
z. Bashkim Murataj**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

Kryetar i lagjes Dukas, z. Ilmi Myftari- unë dua të them disa probleme. Varrezat e Velmishajve duhet të shtohen pak dhe të sheshohet pak vendi. Problemi i liqenit Dukas vazhdon të jetë për urën e kalimit. Gjithashtu te ura te lokali Ben Betës duhen vendosur disa tubo të paktën dhe të rregullohet pasi hidhen edhe mbeturina dhe vjen erë e pakëndshme. Duhet bërë një lulishtë për të moshuarit në lagje.



**Kryetar i lagjes Dukas
z. Ilmi Myftari**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

Anëtare e Këshillit bashkiak, znj. Vjollca Kasaj- përshëndetje! Unë dua të bëj kërkesë për lagjen “1 Maj” pasi në këtë lagje nuk është investuar fare. Kjo lagje ka nevojë për shumë investime duke filluar nga rruga “Koli Marku” e më tej. Ka nevojë për sistemim të shesheve të pallateve, kanalizimeve, ndriçim dhe pastrim. E di që është pjesë e parashikimeve ndërhyrja në këtë lagje, por banorët duan të dinë se kur do të fillojnë këto investime. Derisa të fillohet me ndërhyrjet të paktën të bëhet pastrimi i ferrave në lagje aty ku ka nevojë.



**Anëtare e Këshillit bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli- Lagja 1 Maj është pjesë e investimeve dhe do të ndërhyet sa më parë me të gjithë investimet e parashikuara.



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së.2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

Maj 2025

Banore e lagjes “29 Marsi”, Patos, znj. Fatbardha Kullolli- përshëndetje! Unë banoj në lagjen “29 Marsi” dhe aty po bëhen disa punime tani ku po hapet edhe një parkim makinash. I gjithë pluhuri më hyn brenda në banesë dhe shkakton problem. Gjithashtu është problem për mua pasi unë kam fëmijëtë vegjël dhe hyrja e shtëpisë është direkt në rrugë dhe më dalin fëmijët, kam frikë nga makinat që do kalojnë aty. Një tjetër problem në lagjen time janë edhe qent e rrugës pasi janë shumë të rrezikshëm dhe kërkoj që kjo situatë të zgjidhet.



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Banor në lagjen “Naftëtari”, znj. Alma Grëmbi- unë banoj në lagjen Naftëtari dhe pallati ku u në banoj është parafabrikat dhe po restaurohet. Hyrja e shtëpisë time është nga mbrapa pallatit dhe aty kam një mur të cilin unë kërkoj nga bashkia të mos ma prishin pasi kam vetëm një dhomë dhe ai është mur që mua më prish punë.



**Banor në lagjen “Naftëtari”
znj. Alma Grëmbi**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Këtë pjesë do ta diskutojmë edhe me fimirën dhe do të kryejmë edhe verifikime në terren për të parë se çfatë zgjidhje do të mund

t'ju japim. Nëse ju nuk keni ndonjë kërkesë tjetër do ta deklaroja të mbyllur këtë dëgjese publike. Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj dhe shihemi në dëgjesa dhe takime të tjera!



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishqyrtimi i kërkesave prioritare
mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

Foto të dëgjesës publike me temë: “Rishqyrtimi i kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2026”

20 Maj 2025 Patos



